

Nazmi Maliqi, PhD¹

UDC:
351.96:351.74(497.721)

**МБИКЌЫРЈА ДНЕ КОНТРОЛЛИ ПАРЛАМЕНТАР НДАЈ
СТРУКТУРАВЕ ТЃ СИГУРИСЃ НЃ РРЕТНАНА ДНЕ
ОПЕРАЦИОНЕ ТЃ ВЕЌАНТА - СТУДИМИ И РАСТИТ ТЃ
ИНТЕРВЕНИМИТ ПОЛИКОР НЃ КУМАНОВЃ (9-10 МАЈ 2015)**

**ПАРЛАМЕНТАРНИОТ НАДЗОРОТ И КОНТРОЛА ВРЗ
БЕЗБЕДНОСНИТЕ СТРУКТУРИ ВО ПОСЕБНИ ОКОЛНОСТИ И
ОПЕРАЦИИ - СТУДИЈА НА СЛУЧАЈ ПОЛИЦИСКАТА
ИНТЕРВЕНЦИЈА ВО КУМАНОВО (9-10 МАЈ 2015)**

**PARLIAMENTARY SUPERVISION AND CONTROL ON
SECURITY STRUCTURES IN SPECIAL CIRCUMSTANCES AND
OPERATIONS - CASE STUDY POLICE INTERVENTION IN
KUMANOVO (9-10 MAY 2015)**

Abstract

Through this text is analyzed the legislation and the impact on the Parliament of Macedonia and the Parliament of the Republic of Kosovo, on the building of Security Policies. An analysis was made on the basic sources for determining the position of the Assembly of the Republic of Macedonia, the Constitution, the Rules of Procedure of the Parliament of the Republic of Macedonia. It was also clarified the role and work of parliamentary committees through parental control and control in extraordinary events in building Security Policies

Democratic control over security structures is based on several reasons: building a culture of security that citizens can accept police, army, secret intelligence and counter intelligence services more closely. The other reason is the creation of conditions for the protection of

¹ Ligjërues në Universitetin FON, Fakulteti shkencave politike dhe diplomacisë dhe Kryeredaktor i Revistës të shkencave shoqërore *Vizione* - www.visionsmagazine.org

"human rights and freedoms" to citizens, but also within the employees of their superiors. Special duties, or high state secrets, which remain the property of a narrow circle of designed hierarchy, may be the worst way if they avoid parliamentary scrutiny.

Prior to and during the police intervention in Kumanovo (09 10 May 2015), given the bloody clash that occurred with the loss of human life and many injured people, which was declared to everyone as a dangerous area, the MPs were without interest. The battle took place with the use of grenades, shots, fierce clashes between police units and the armed group, MPs never asked for information from the Macedonian Interior Ministry, why was allowed, or why did this bloody situation in a peace situation.

Regarding the situation of the conflict that took place in Kumanovo on 9 and 10 May 2015, this paralyzing structure was put in the midst of bad parliamentary practices.

Key words: Security Policy, Parallel Control, Comparison, Regional Cooperation and Euro-Atlantic Integrations.

Hyrje

Partitë politike shqiptare, duhet të orientohen në projekte funksionale, në ndarjen e të drejtave dhe përgjegjësi me partitë politike maqedonase, në kthimin e shtetit në binar normal. Njerëzit përgjegjës, udhëheqës të partive politike, energjinë e tyre konsumojnë pa asnjë arsye të veçantë, për komunikim përmes tezave të patriotizmit sezonal, varësisht prej situatave duke profilizuar patriotizëm të panevojshëm me ç'rast anashkalohen projektet, që krijojnë një konkurrencë më të bindshme, për mirëqenie, për edukim ligjor dhe edukim fetar. Parashtrohet pyetja pse gëzohen kur gjoja humbin të tjerët, nëse janë humbës të përbashkët. Është shqetësuese përse projektet konkurruese përjashtohen me vite si vlerë për konkurrencë politike, ekonomike, arsimore, të ambientit jetësor, kultura fiskale shtetërore, kundër dukurive devijuese, etj. Shpëtimi i vetëm i Republikës së Maqedonisë, për të mbetur si shtet stabil është përafrimi më i bindshëm drejt rregullave dhe porosive të BE-së dhe NATO-s.

Parashtrohet një dilemë hulumtuese. Çka sollën përgjimet e funksionarëve shqiptarë dhe maqedonas në këto 10 vitet e kaluara? Edhe pse ato përgjime ishin kundërligjore, por megjithatë, nëse analizohen se çka bisedonin elita e BDI-së, kryetari, kryetarët e komunave, ministrat dhe funksionarë të tjerë, në asnjë bisedë të përgjuar nuk bëhet fjalë për interesin e qytetarëve. Asnjë bisedë nuk kishte të bëjë me të drejtat e

shqiptarëve, me edukatën ligjore dhe edukatën fetare, të kodit etik në politikëbërje. Bisedohej për interesa të tepërta personale dhe familjare, në momente edhe biseda që e dëmtojnë edhe etikën morale qytetare.

Nga shkelja e ligjeve përmes përgjimeve dhe rasteve të montuara politike, viktima gjithmonë ishin shqiptarët. “Në mënyrë të këtillë të vrazhdë dhe jo ligjore në të shumtën e rasteve viktima ishin shqiptarët. Shembuj të praktikave të këqija, për fat të keq ndodhin edhe pas vitit 2001, edhe pas nënshkrimit të një dokumenti të pajtimit, siç është “Marrëveshja Kornizë e Ohrit”. Kishte montime të ndryshme, inskenime të ndryshme që përfunduan me vrasje, burgosje, tortura edhe para anëtarëve të familjes. Pjesë e këtyre veprimeve së bashku me VMRO-DPMNE dhe LSDM ishin edhe dy partitë politike shqiptare BDI dhe PDSH.”²

Nëse në Maqedoni është rregulluar korniza ligjore e sferës së ruajtjes së privatësisë së qytetarëve të këtij shteti. Ligjet në vend gjithmonë janë thyer nga partitë në pushtet, së bashku edhe partitë opozitare të cilave në kontinuitet u ka munguar ndërgjegjja për mbikëqyrje dhe kontroll parlamentar, në zbatimin e këtyre ligjeve. Qeveritë e Republikës së Maqedonisë, LSDM-PPD (1994-998), VMRO-DPMNE-PDSH (1998-2002), LSDM-BDI (2002-2006) VMRO-DPMNE-PDSH (2006-2008), VMRO-DPMNE-BDI (2008-2016) mbetën rob apo peng të antivlerave për ndërtimin e shtetit.

Me vite, u janë dorëzuar kurtheve famëkeqe të korrupsionit, pasurimit të paligjshëm, përgjimit dhe të kushtëzimeve të mbrapshta të natyrave të ndryshme. Qytetarët e Maqedonisë mbeten peng të krimit të organizuar pasi partitë politike janë të përfshirë në mosrespektimin e ligjeve dhe Kushtetutës. Pastaj ka një numër të mangësive dhe parregullsive në funksionimin e shtetit në këtë kohë, që do të thotë se qytetarët nuk meritojnë të jenë robër të politikës joparimore dhe jofunksionale, sepse ne tashmë jetojmë në rrethana të tilla dhe se durimi i qytetarëve një ditë mund të humbasë.

Korniza normative, ligjet sistemore, me të cilat duhet të ndërtohet shteti edhe në sferën e informacioneve

Nëse shikojmë kornizën normative, ligjet sistemore, me të cilat duhet të ndërtohet shteti edhe në sferën e informacioneve, me mos zbatimin e tyre, apo me shkeljen e tyre, duke filluar me Ligjin për qasje në informacione me karakter publik, Ligjin për sigurinë e informacioneve të klasifikuara, Ligji për sigurinë e privatësisë apo për sigurinë e

²N.M. <http://archive.zhurnal.mk/content/?id=15381662154>, (08. Mars 2015)

informacioneve personale, Ligji për komunikimet elektronike, e kështu me radhë. Në këto ligje shohim standarde evropiane për të funksionuar praktikat e mira. Me këto ligje vendosen qartas konceptet ligjore që mund të janë të zbatueshme. Këtu është e keqja, ata të cilët duhet të kërkojnë zbatimin e ligjshmërisë, këta janë shkelësit e vrazhdë, mund të them edhe të pamëshirshëm, me moszgjedhjen e mjeteve, që me çdo kusht të vihet apo të mbetet në pushtet. Sa i përket partive politike shqiptare BDI dhe PDSH, është shumë e vërtetë, në një mënyrë apo tjetër, po paraqiten si aktorë të këtyre shkeljeve ligjore. Komunikimi politik i tyre bëhej në hijen e akuzave, sharjeve mes vete, mbajtja gjallë e një fjalori të ulët të komunikimit brendashqiptar. Kjo praktikë e komunikimit të pakujdesshëm brendashqiptar, nuk duhet që të ngel në harresë, për praktikën e keqe të politikëbërjes.

Ndodhitë e përgjimit, edhe pse ishte praktikë e kahershme e partive politike që ishin dhe që janë në pushtet, me të drejtë i kanë zhgënjyer të gjithë miqtë dhe dashamirët që dëshirojnë ta shohin Republikën e Maqedonisë si shtet stabil. Kuptohet, zhgënjyen edhe ambasadorët në Shkup, që kjo praktikë e tillë e mbrapsht, me vite po ndodhë para syve të tyre.³

Është me të vërtetë e trishtueshme të torturohen qytetarët me afëra të vazhdueshme, duke u fshehur faktet e aktorëve shtetërorë për manipulimet e tyre, me shkeljen e ligjeve në politika të dëmshme dhe korruptive.

Mbikëqyrjen Parlamentare:

Shërbimet e Sigurisë duhet të japin llogari para secilës degë kryesore të shtetit:

Legjislativi që ushtron mbikëqyrje parlamentare, duke kaluar ligje që përcaktojnë dhe rregullojnë shërbime të sigurisë dhe kompetencat e tyre dhe duke miratuar mjete përkatëse buxhetore, që përfshinë edhe caktimin e një Avokati të Popullit apo komisionit parlamentar që mund të ndërmarrë hetime në lidhje me ankesat e publikut

Ekzekutivi ushtron kontroll të drejtpërdrejtë nga nivelet qendrore, rajonale apo vendore të qeverisë, përcakton buxhetin, udhëzuesit e përgjithshëm dhe përparësitë e veprimtarive të shërbimeve të sigurisë

Në kuadër të harmonizimit të reformave me pajtim me standardet e NATO-s dhe BE-së, nevojitet të bëhet përkufizim i kompetencave të strukturave të sigurisë (ushtrisë, policisë, drejtorisë për siguri dhe kundërzbulim, agjencisë për zbulim, drejtorisë për menaxhim me krizë) dhe afrimit të kontrollit efikas demokratik parlamentar të sektorit të sigurisë.

³ N.M. <http://archive.zhurnal.mk/content/?id=15381662154>, (08. Mars 2015).

Me standardet dhe praktikat më të mira ligjore duhet të krijohet mbikëqyrje e shërbimeve të fshehta të sigurisë dhe informacionit në katër nivele. Secili prej tyre mund të konsiderohet si një shtresë e mbikëqyrjes demokratike që përfshihet në shtresën tjetër: Kontrolli i brendshëm në nivelin e agjencisë, kontrolli nga ana e ekzekutivit, mbikëqyrja parlamentare dhe mbikëqyrja nga ana e organeve të pavarura të mbikëqyrjes⁴.

**Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë,
nëpërmjet Komisionit për mbrojtje dhe siguri, parasheh:**

- Mbrojtjen e rendit të përcaktuar me kushtetutë; realizimin e mbikëqyrjes në domenin e mbrojtjes dhe sigurisë; mbajtjen e rendit dhe qetësisë publike; kalimin e kufijve shtetërorë dhe lëvizjen dhe qëndrimin në brezin kufitar; lëvizjen dhe qëndrimin e të huajve; përcaktimin dhe zgjidhjen e incidenteve kufitare dhe shkelje të tjera të kufijve shtetërorë etj.⁵

**Komisioni për mbikëqyrjen e punës së drejtorisë për siguri
dhe kundërzbulim dhe të agjencisë për zbulim**

Ligji për Punë të Brendshme i Republikës së Maqedonisë, rregullon punën e komisionit, që ka të bëjë me Mbikëqyrjen e punës së Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim dhe të Agjencisë për Zbulim. Komisioni për kontroll të shërbimeve sekrete, pranë Kuvendit i cili përbëhet nga: kryetari, tetë (8) anëtarët dhe zëvendësit e tyre.⁶

**Komisioni për Kontroll të shërbimeve sekrete i kuvendit,
shqyrton çështjet lidhur me:**

- Respektimin e të drejtave dhe lirive, të përcaktuara me kushtetutë dhe ligje nga ana e Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim dhe Agjencisë për Zbulim;

- Ligjshmërinë në zbatimin e autorizimeve të Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim dhe Agjencisë për Zbulim, nga aspekti i kapërcimit të autorizimeve, ndërmarrjes së procedurave të paautorizuara, keqpërdorim dhe negativitete të tjera në punën, në kundërshtim me të drejtat e tyre të përcaktuara me ligj;

⁴ Udhëzues të DAC dhe Seria e referencave “Reforma në sistemin e sigurisë dhe qeverisja: drejtimi polik dhe praktika e mire”, DICA, Gjenevë, 2004.

⁵ Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë (tekst i spastruar) (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, numër 130/2010).

⁶ Deputetë shqiptarë në Komisioni për mbikëqyrjen e punës së drejtorisë për siguri dhe kundërzbulim dhe të agjencisë për zbulim: Zulfi Adili; Ernad Fejzullahu; Rafiz Haliti dhe Orhan Ibrahim (https://www.sobranie.mk/trupat-punues-2014-2018-ns_article-komisioni-per-mbikëqyrjen-per-zbulim-2014-2018.nsp).

- Metodrat dhe mjetet që i shfrytëzojnë Drejtoria për Siguri dhe Kundërzbulim dhe Agjencia për Zbulim, nga aspekti i ligjshmërisë dhe respektimit të drejtave të qytetarëve dhe subjekteve tjera;

- Pajisjen materiale, kuadrore dhe teknike të Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim dhe Agjencisë për Zbulim.

Komisioni, i shqyrton çështjet në lidhje me: mbikëqyrjen e realizimit, masa për të monitoruar komunikimet nga Ministria e Brendshme dhe Ministria e Mbrojtjes, legaliteti në zbatimin e masave për të monitoruar komunikimet nga Ministria e Brendshme dhe Ministria e Mbrojtjes dhe në përputhje me Aktin për të monitoruar dhe çështjet tjera. Komisioni për mbikëqyrjen mbi zbatimin e masave për të monitoruar komunikimet, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Mbrojtjes në përputhje me përgjegjësitë, mori vendim, për krijimin e Trupit të përhershëm punues të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë.

Do të ishte tepër e rrezikshme për çdo vend nëse shërbimet e sigurisë nuk i raportojnë organeve që janë ura lidhëse me qytetarët dhe të cilat nuk do të mbikëqyrreshin prej askujt, sidomos prej shtëpisë së legjislativit.

Natyra e shërbimeve të sigurisë përgjatë operacioneve të ndryshme është e tillë që mund të shoqërohet me kolorit pasojash fillimisht për qytetarët dhe pastaj për vetë shtetin. Prandaj, kur të dihet paraprakisht se operacionet në vazhdimësi i nënshtrohen mbikëqyrjes dhe raportimeve, atëherë doemos përgjatë operacioneve të shërbimeve të sigurisë ngrihet kujdesi dhe vëmendja, sepse tjetër gjë është të vepros kur e di se nuk mbikëqyrresh prej askujt dhe tjetër gjë kur mbikëqyrresh.

Në nenin 129 të Kushtetutës së Kosovës precizohet se “Agjencia e Kosovës për Inteligjencë zbulon, heton dhe mbikëqyr kërcënimet ndaj sigurisë në Republikën e Kosovës. Agjencia e Kosovës për Inteligjencë është profesioniste, politikisht e paanshme, shumetnike dhe i nënshtrohet mbikëqyrjes nga Kuvendi në mënyrën e përcaktuar me ligj. Presidenti i Republikës së Kosovës dhe Kryeministri, pas konsultimit me Qeverinë, së bashku emërojnë Drejtorin, Zëvendës Drejtorin dhe Inspektorin e përgjithshëm të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë. Kualifikimi dhe mandati, rregullohen me ligj. Presidenti i Republikës së Kosovës dhe Kryeministri marrin të njëjtat informacione në lidhje me inteligjencën”. Përkundër këtij përkufizimi kushtetues, akoma mungon precizimi ligjor për formimin e shërbimeve të inteligjencës. Me siguri nga e gjithë kjo kurth që ndodhi me rastin e konfliktit të

Kumanovës më 9 dhe 10 maj 2015, ka nevojë të dihet zyrtarisht se cili ishte edhe roli i shërbimeve të sigurisë së Kosovës.

Ligjet për ruajtjen e sekretit mund të pengojnë përpjekjet për rritjen e transparencës në fushën e sigurisë; fusha e Sigurisë është shumë e ndërlikuar në parlamentet duhet të mbikëqyrin çështjet si prokurimi i armëve, kontrolli i armëve dhe gatishmëria e njësisve të armatosura; nënvizimi i bashkëpunimit ndërkombëtar për sigurinë mund të ushtrojë ndikim mbi transparencën dhe ligjshmërinë demokratike të politikës së sigurisë.⁷ Ligji për kuvendin e Republikës së Maqedonisë⁸, ofron bazë të hollësishme, për deputetët që t'i realizojnë obligimet e tyre.

Kontrolli demokratik mbi strukturat e sigurisë⁹ mbështetet në disa arsye: ngritja e kulturës së sigurisë që qytetarët t'i pranojnë më të afërta policinë, ushtrinë, strukturat e shërbimeve sekrete të zbulimit dhe kundërzbulimit¹⁰. Arsyeja tjetër është krijimi kushteve për mbrojtjen e “të drejtave dhe lirive të njeriut”¹¹ ndaj qytetarëve, por edhe brenda të punësuarve nga eprorët e tyre¹². **Detyrat e veçanta¹³**, apo të sekretit të lart shtetëror, që mbetet pronësi e një rrethi të ngusht e hierarkisë së dizajnuar, mund të jetë mënyra më e keqe nëse i shmangen kontrollit parlamentar.

⁷ Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Nenet 6, 8, 9, 10 dhe 11.

⁸ <https://www.sobranie.mk/ligji-per-kuvendin-e-rm-se.nspk>

⁹ Deputetët shqiptarë në Komisionin parlamentar për mbrojtje dhe siguri: Talat Xhaferi, Vjollca Mehmeti Nuredini, **Jamin Sinani**, Artan Grubi dhe Orhan Ibraimi. (mandati parlamentar 2014-2016) https://www.sobranie.mk/trupat-punues-2014-2018-ns_article-komisioni-per-mbrojtje-dhe-siguri-2014-2018.nspk

¹⁰ Shih më gjerësisht, Kontrollueshmëria e shërbimeve të fshehta: standardet ligjore dhe praktika më e mirë, Qendra e Gjenevës për Kontroll Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF) Gjeneve, 2006.

¹¹ Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Nenet 6, 8, 9, 10 dhe 11.

¹² Rekomandim 1402, (1999), Këshilli i Evropës (Asambleja Parlamentare) Shërbimet e sigurisë së brendshme duhet të respektojnë Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Çdo ndërhyrje e veprimtarive operative të shërbimeve të sigurisë së brendshme në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut duhet të autorizohet me ligj. “Legjislativi duhet të miratojë ligje të qarta dhe të përshtatshme duke i vënë shërbimet e sigurisë së brendshme në një bazë ligjore”.

¹³ Komisioni parlamentar për mbikëqyrjen e zbatimit të masës së veçantë hetuese - ndjekja e komunikimeve nga Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e policisë financiare, Drejtoria doganore dhe Ministria e Mbrojtjes, deputetë shqiptarë në këtë komision: Talat Xhaferi, Ernad Fejzullahu, Ejup Rustemi dhe Imer Aliu (https://www.sobranie.mk/trupat-punues-2014-2018-ns_article-komisioni-per-mbikëqyrjen-e-zbatimit-te-masave-ministria-e-puneve-dhe-ministria-e-mbrojtjes-2014-2018.nspk)

Mungoi kontrolli dhe mbikëqyrja parlamentare në situatat të jashtëzakonshme siç ishte rasti i Kumanovës më 9 dhe 10 maj 2015

Për fat të keq, në vendin tonë ekziston kuazi-nacionalizmi, politikat e sëmura, shkeljet drejtave të njeriut brenda-maqedonase dhe brenda-shqiptare; jotoleranca brenda partiake dhe brenda partisë; përgjimi i paligjshëm, nepotizmi, administrata dhe gjyqësori partiak apo i partizuar; korrupsioni ose mungesa e moralit të shfaqur nga personat dhe elita politike. Elita politike e trajton shtetin pothuajse si një kompani të tyre private.¹⁴

Korrupsioni i udhëheqjeve të partisë brenda komuniteteve përkatëse kombëtare, manipulime të ndryshme me ndjenjat kombëtare-patriotike të qytetarëve me qëllim të arritjes së interesave personale duke e përdorur këtë si një maskë në shumë raste për të fshehur mungesën e suksesit: mosrealizimi i detyrimit e dhëna nga votuesit; abuzimet në aspektin e pozitës shoqërore të të rinjve me qëllim të arritjes së interesave politike etj. Të gjitha këto paraqesin kërcënim për integritetin moral të njerëzve, veçanërisht atyre që janë vendosur për të jetuar në mënyrë të ndershme.

Shfaqja e konflikteve dhe periudha pas konfliktit duket të jetë një terren për praninë e frikës dhe dëshpërimit të fuqishëm, e cila shoqërohet me ndjenja të padrejta dhe të pakëndshme, shqetësime, shfaqje zhgënjimi, kriza individuale dhe ngjarje të tjera negative të lidhura. Këto jo-vlera kontribuan për kategorinë e njerëzve që të bien thellë në krizat morale, kështu që një pjesë e tyre kanë vazhduar të kërkojnë mundësitë dhe sigurinë e tyre ekzistenciale larg shtëpive të tyre dhe kështu ata kurrë nuk do të mendonin më për vendin e tyre të lindjes . Ky lloj sjelljeje ka një ndikim të madh në qytetarët tanë kur merren në konsideratë shumë nga faktorët për shembull; familja ka të bëjë me pasigurinë e shumëve të ardhurave në familje; numri i të papunëve në familje dhe mungesa e prosperitetit etj.

Ekzistojnë vlerësime serioze se funksionimi i shoqërive demokratike rrezikohen nga kriminaliteti i organizuar, droga, prostitucioni, trafikimi i kundërligjshëm i njerëzve dhe mallrave. Shërbimet e fshehta të sigurisë dhe të informacionit kanë për detyrë të mbledhin dhe të analizojnë informacione për këto rreziqe të mundshme dhe të bëjnë vlerësime. Devijimi profesional apo korruptimi i strukturave të shërbimeve sekrete, hapë rrugët e krimit të organizuar. Zaten edhe nuk mund të ketë kriminalitetet

¹⁴ Shih më gjerësisht, Kontrollueshmëria e shërbimeve të fshehta: standardet ligjore dhe praktika më e mirë, Qendra e Gjenevës për Kontroll Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF) Gjeneve, 2006.

të organizuar, nëse nuk janë implikuar pjesëtarët e strukturave të sigurisë të shtetit.¹⁵ Bartësit e disenjimit të strukturave të sigurisë sekrete, nuk duhet lejuar që në emër të “Sigurisë kombëtare” të krijojnë vetëbesueshmëri, apo të ngrihen mbi ligjin për realizimin e të drejtave dhe obligimeve të tyre. Askujt nuk duhet t’i lejohet të ngrihet mbi ligjin. Pikërisht këtu është edhe roli i pazëvendësueshëm i parlamentit në mbikëqyrjen e strukturave sekrete të sigurimit, për të ruajtur angazhimin ndaj shtetit ligjor që karakterizon shtetet demokratike, edhe në situata të tejskajshme. Përkundrazi, kompetencat e veçanta të shërbimeve të sigurisë duhet të mbështeten në një kuadër ligjor dhe në një sistem të kontrolleve ligjore.

Gjatë intervenimit policor në Kumanovë (9 maj 2015) duke pasur parasysh përplasjen e përgjakshme që ndodhi me humbjen e jetëve njerëzore si dhe shumë njerëz të plagosur, gjë që u deklarua për të gjithë, si zonë e rrezikshme. Beteja u zhvilluan me përdorimin e granatave, të shtënave, përleshje të ashpra midis pjesëtarëve të policisë dhe grupit të armatosur. Banorët e periferisë ku ndodhi konflikti, u lanë në pozitë të mjeruar në shtëpitë e tyre. Në këto rrethana, politikanët, njerëzit me ndikim politik, me ndikimin e partisë në pushtet, përkatësisht VMRO-DPMNE-së, BDI-së dhe PDSH-së, duhet të kuptojnë, se më së miri do të ishte shmangia e këtyre eksperimenteve dhe skenarëve, të cilat mund të kishin destabilizim me efekt antinjerëzor.¹⁶

Në lidhje me situatën e konfliktit që ndodhi në Kumanovë më 9 dhe 10 maj 2015, qeveria e këtij mandati parlamentar, mund të radhitet në mesin e qeverive të këqija. Qeveria e Kosovës në cilin pozicion ishte, kurrë nuk mbante llogari për qytetarët e vet. Sipas informacioneve më të vonshme këta qytetarë të Kosovës, me javë të tëra ishin në Gjilan, Kaçanik, Viti, në rrugëtimin e paqartë drejtë Kumanovës dhe Likovës. Pse nuk u respektua Kushtetuta dhe Ligjet e Kosovës nga Qeveria e

¹⁵ Shërbimet e fshehta të sigurisë dhe informacionit duhet t’u përgjigjen nevojave të njerëzve nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të zgjedhur, d.m.th. civilëve të zgjedhur në kabinet dhe në parlament, të cilët mëshirojnë mbizotërimin e kontrollit politik mbi shërbimet e fshehta të sigurisë dhe informacionit. Shkurt, mbikëqyrja demokratike e shërbimeve të fshehta të sigurisë dhe informacionit përfshin një seri institucionesh dhe aktorësh. (Udhëzues të DAC, DICA, Gjenevë, 2004).

¹⁶ Rekomandim 1402, (1999), Këshilli i Evropës (Asambleja Parlamentare) Shërbimet e sigurisë së brendshme duhet të respektojnë Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Çdo ndërhyrje e veprimtarive operative të shërbimeve të sigurisë së brendshme në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut duhet të autorizohet me ligj.” “Legjislativi duhet të miratojë ligje të qarta dhe të përshtatshme duke i vënë shërbimet e sigurisë së brendshme në një bazë ligjore”.

Kosovës, për vënien e formave të dialogimit me qytetarët e vet, për shmangie nga rrugëtimi i paqartë.

Në nenin 129 të Kushtetutës të Kosovës precizohet se “Agjencia e Kosovës për Inteligjencë zbulon, heton dhe mbikëqyr kërcënimet ndaj sigurisë në Republikën e Kosovës. Agjencia e Kosovës për Inteligjencë është profesioniste, politikisht e paanshme, shumetnike dhe i nënshtrohet mbikëqyrjes nga Kuvendi në mënyrën e përcaktuar me ligj. Presidenti i Republikës së Kosovës dhe Kryeministri marrin të njëjtat informacione në lidhje me inteligjencën”. Me fjalë tjera, reformat në strukturat e sigurisë janë sfidë, gjegjësisht nevojë shoqërore dhe do të kontribuonin për zgjidhjen e drejtë të problemeve për mbrojtjen e shtetit, të vlerave demokratike. Më pas, me vendosjen e kontrollit demokratik dhe civil, konstruksionit, gjegjësisht transformimit të forcave të sigurisë sipas standardeve të NATO-s, stërvitjet dhe përgatitja profesionale e kuadrit, me reforma që si bazë do ta kishin strategjinë mbrojtëse të orientuar drejt strukturave euroatlantike, NATO-s dhe BE-së¹⁷.

Praktikat e këqija të parlamenteve të Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Kosovës

Në menaxhimin e keq të dy qeverive Kosovë-Maqedoni, u pengua mënyra paqësore e tejkalimit dhe zgjidhjes së konfliktit. Një porosi e keqe për kohën e sotme, në politikat për përafrimin e këtyre shteteve në NATO dhe BE. Kush mund të jetë ai që përfiton nga sjellja e Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë? Qeveria e Republikës së Maqedonisë duhej të përmbushte përgjegjësitë e saj shtetërore dhe humane, përmes gjetjes së një projekti paqësor dhe kështu të parandalonte një konflikt të armatosur.

Mungoi etika profesionale dhe morale e deputetëve shqiptarë për kërkimin e informacionit zyrtar të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Maqedonisë dhe Kosovës për ngjarjet e Kumanovës (9 dhe 11 maj 2015)

Me rastin e dhimbshëm dhe të turpshëm të partive politike parlamentare, veçmas për **Bashkimin Demokratik për Integrim** e cila më tepër kishin sqarime të papërgjegjshme, u mungoi vetëdija profe-

¹⁷Specifikimi i “Kritereve të Kopenhagës” për praninë duhet të përfshijë: “Kontrollueshmërinë ligjore të shërbimeve policore, ushtarake dhe të fshehta, do të kontribuohet për zgjidhjen e problemeve në të gjitha strukturat e sigurisë, Programi 2000, § 9 BE (Parlamenti Evropian).

sionale, u mungoi ndërgjegjia humane, që përmes vijës zyrtare të kërkohet informacion nga Strukturat e sigurisë së Republikën e Maqedonisë, siç ndodhi rasti i Kumanovës. Cila ishte përgjegjësia e grupit parlamentar të BDI-së¹⁸ dhe trupi koordinues që u shndërruan në gjumë dimëror, pa interesim parlamentar, pa i shfrytëzuar mekanizmat zyrtarë parlamentar për dhënien e informacioneve pse nuk funksionoi veprimi parandalues për zgjidhjen dhe tejkalimin e situatës që u shndërrua në konflikt me humbje të madhe në njerëz nga dy palët. Cili ishte roli parlamentar opozitar i PDSH-së¹⁹ për të njëjtat çështje ku dëmtuan thellë të drejtat e njeriut, të drejtat humanitare.

Pas gjykimeve të 11 nëntorit - Kërkesë e vonuar për krijimin e komisionit anketues parlamentar për rastin e Kumanovës (9 dhe 11 maj 2015)

“Grupi i Kumanovës” i cili u përlësh në maj të 2015 me forcat e sigurisë në Maqedoni, u cilësua veprime me qëllime politike për të drejtat e shqiptarëve në Maqedoni.

Heshtja e deputeteve shqiptarë në Parlamentin e RM-së dhe në Parlamentin e Kosovës, që nuk kërkuan me kohë informacion zyrtar nga Ministria e Punëve të Brendshme të Maqedonisë dhe të Kosovës, kontribuan për të krijuar turbullira, nga më të ndryshmet të shërbimeve sekrete. Qysh nga koha kur këta shqiptarë u burgosën, ku një pjesë e tyre edhe u vranë padrejtësisht në mënyrë çnjerëzore, të cilët vdiqën nga torturat nëpër stacione të policisë.

Një kumtesë fare e pakuptimtë e Bashkimit Demokratik për gjykimin e “Grupit të Kumanovës” ku thotë se për këtë rast duhet hetim ndërkombëtar. Parashtrohet një dileme, që kërkon përgjigje zyrtare, pse mungoi kërkesa e parlamentarëve shqiptarë në Parlamentin e Maqedonisë, për informacion zyrtar, si ndodhi dhe pse u lejua të ndodhe kjo ngjarje aq dhimbshme dhe shumë e turpshme për kohën e sotme.

¹⁸ Deputetët e BDI-së në legjislaturën 2014-2016: Ali Ahmeti, Artan Grubi, Vjollca Mehmeti-Nuredini, Ejup Rustemi, Jamin Sinani, Kaltrina Azizi, Mirvan Xhemaili, Mirsada Emini-Asani, Musa Ibraimi, Nora Aliti, Rafiz Aliti, Ramiz Merko, Rexhail Ismaili, Selvije Saliu, Hazbi Lika, Shpresa Hadri; Koordinator: Talat Xhaferi; Zëvendëskoordinator: Ermira Mehmeti dhe zëvendëskoordinator: Xhevat Ademi.

¹⁹ Deputetët e PDSH-se në legjislaturën 2014-2016: Gazmend Aliji, Ernad Fejzulla, Mendu Thaqi, Meral Uzeiri-Ferati; Koordinator: Imer Aliu; Zëvendëskoordinator: Bekim Fazliu, zëvendëskoordinator: Orhan Ibrahim.

Me siguri se kjo kumtesë dhe kërkesë do të kishte kuptim, nëse nga deputetët me kohë do të kërkohej informacion zyrtar.

Pse ishin të fjetur njerëzit e zgjedhur me votën e popullit për t'i shfrytëzuar mekanizmat paqësore për parandalimin e konfliktit. Apo cila ishte arsyeja, që politikanët shqiptarë në Maqedoni dhe Kosovë, ishin shumë larg, sikur kjo ngjarje të ndodhte diku në Afrikë dhe jo para syve të tyre. Shumica e aktorëve të konfliktit në një lagje në Kumanovë, ishin njerëz të afërt të BDI-së dhe PDSH-së, njerëz të afërt të PDK-së dhe AAK-së në Kosovë.

Parashtrohet një dilemë tepër e arsyeshme, pse mungoi vullneti atdhetar, vullneti human për vënien e vijave të arsyeshme të komunikimit me shokët e tyre të luftës të UÇK-së në Kosovë dhe në Maqedoni. Sjellja aq me painteresim e aktorëve të politikës shqiptare në Kosovë dhe Maqedoni, sjell edhe shumë dilema, që ndoshta një ditë edhe do të argumentohen. Ndoshta ky konflikt një pjese të politikanëve edhe u konvenonte, për të defokusuar politikën e pasuksesshme të tyre, për t'i dhënë jetë politikave korruptuese.

Pse nuk u vu kontakt zyrtar për deshifrimin e arsyeve, pse këta njerëz, me javë të tëra lëviznin nëpër Gjilan, Viti, Kaçanik, Komunën e Likovës dhe Kumanovë. Madje kjo neglizhencë, ky sjellje antihumane e aktorëve politik shqiptarë, në asnjë mënyrë nuk i largon nga përgjegjësia edhe aktorët e politikave nga radhët e partive maqedonase. Së paku të kishin kërkuar zyrtarisht, përse u krijua konflikti i armatosur në Kumanovë? Cilat ishin masat për pengimin e konfliktit të armatosur? Kjo kërkesë për vënien e një vije institucionale, me kërkesë zyrtare mungoi edhe në radhët e deputetëve të BDI-së dhe PDSH-së, po ashtu një kërkesë e tillë, mungoi edhe nga deputetët e parlamentit të Kosovës.

Nevoja për mbikëqyrjen e shërbimeve të fshehta të sigurisë e të informacionit

Kontrolli publik i këtyre shërbimeve është i rëndësishëm për të paktën pesë arsye.

Koncepti i hapjes dhe i transparencës që qëndron në bazë të mbikëqyrjes demokratike, shërbimet e fshehta të sigurisë dhe informacionit shpeshherë punojnë në fshehtësi. Meqenëse fshehtësia mund t'i ruajë operacionet e tyre nga shqyrtimi i hollësishëm nga ana e opinionit publik, është e rëndësishme që parlamenti dhe, sidomos, ekzekutivi t'i ndjekin nga afër operacionet e këtyre shërbimeve.

Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (CoE): Ekzistojnë shqetësime serioze se shërbimet e brendshme të sigurisë të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës shpeshherë vënë interesin e asaj që ato e mendojnë si interes të sigurisë kombëtare dhe të vendit të tyre mbi respektimin e të drejtave të individit.

Mbikëqyrja e shërbimeve të sigurisë në veprim është një fushë komplekse. Përgjatë kësaj procedure gërshetohen shumë plane dhe veprime. Për shkak të natyrës së këtij veprimi, nuk përjashtohen situatat e përjashtimit, mirëpo para se gjithash edhe në këto situata duhet pasur parasysh të Drejtën Humanitare Ndërkombëtare. Gjendja e luftës po ashtu nuk është një çështje e lehtë, ngaqë përsikaj pasojave të shumta që ndodhin nëpër luftëra, në gjendje lufte edhe pajisjet për mbikëqyrjen e shërbimeve të fshehta të sigurisë nuk janë të plota. Fundi fundit, tërë kjo bëhet për ta ruajtur sigurinë e brendshme të një shteti.

Shërbimeve sekrete mes tjerash u duhet të ballafaqohen edhe me operacionet e shërbimeve të huaja sekrete dhe kjo këtë segment goxha shumë e ndërlikon dhe e vështirëson. Po ashtu, terrorizmi është një nga rreziqet kundër të cilit shtetet duhet t'i mbrojnë qytetarët e tyre. Kjo më se miri mund të arrihet përmes forcimit të shërbimeve të sigurisë dhe mbikëqyrjen e tyre parlamentare.²⁰

Përfundim

Të gjithë duhet të bartin përgjegjësinë për jetën e humbur njerëzore. Pyetja që del në vijim është, se cilat masa janë ndërmarrë, nëse janë marrë për të tejkaluar këtë konflikt në mënyrë paqësore. Ishte e nevojshme që një veprim i tillë të zhvillohej në orët e hershme të mëngjesit, përpara se të konsultohet me përfaqësuesit ndërkombëtarë të bashkësisë ndërkombëtare. A kishte ndonjë mundësi për të përdorur një taktikë më të suksesshme për të kapërcyer këtë problem? Cili ishte roli i aktiviteteve të agjencive të kundërzbulimit, të cilat mund të kishin ndihmuar në transformimin në kohë të këtij problemi? Qytetarët

²⁰ Në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut thuhet se në një shoqëri demokratike e drejta e jetës private (Neni 8), liria e mendimit, ndërgjegjes dhe besimit (Neni 9), si dhe liria e shprehjes (Neni 10) dhe liria për t'u mbledhur dhe organizuar në shoqata (Neni 11) mund të kufizohet, ndër të tjera, për interesa të sigurisë kombëtare dhe të rendit publik. Sidoqoftë, Konventa gjithashtu parashikon se këto kufizime duhet të bëhen "në përputhje me ligjin". Në një çështje ligjore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut thuhet, ndër të tjera, se shërbimet e fshehta të sigurisë dhe informacionit mund t'i ushtrojnë kompetencat e tyre të veçanta vetëm në qoftë se ato rregullohen me ligj.

pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike dhe duke pasur parasysh standardin e vërtetë të statusit të ulët shoqëror, pa fajin e tyre, pse ishin nënshtruar këtij rrethimi dhe bombardimet e qytetit të tyre.

Normat dhe standardet e mbikëqyrjes së shërbimit të sigurisë dhe të shërbimit të fshehtë të informacionit, siç zbatohen nga organizatat ndërkombëtare rajonale dhe globale. Mbikëqyrja demokratike: institucionet dhe aktorët e ndryshëm; Kontrollueshmëria demokratike e shërbimeve të fshehta të informacionit kërkon që të ushtrohet kontroll nga ana e ekzekutivit dhe mbikëqyrje nga ana e parlamentit, si dhe kontribut nga ana e shoqërisë civile. Shërbimet e fshehta të sigurisë dhe informacionit duhet t'u përgjigjen nevojave të njerëzve nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të zgjedhur, d.m.th, civilëve të zgjedhur në kabinet dhe në parlament, të cilët mëshirojnë mbizotërimin e kontrollit politik mbi shërbimet e fshehta të sigurisë dhe informacionit. Shkurt, mbikëqyrja demokratike e shërbimeve të fshehta nga deputetët në parlamentin e Maqedonisë nuk ekzistonte.

Literatura e konsultuar

- Zejnullah GRUDA, Mbrojtja Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut (Dokumente, Botimi i Dytë), Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore (4 nëntor 1950), Prishtinë, 2001
- Giovanni SARTORI, (Përkthyer nga: Kujtim YMERI), Ç'është Demokracia, Tiranë, 1998
- Kurtesh SALIU, E Drejta Kushtetuese, Libri Parë (Botimi i Tretë), Tetovë, 2002
- Kurtesh SALIU, Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë (Teksti jozyrtar, i spastruar, për përdorim intern), Tetovë, 2007
- Llambro FILO, Sistemet Politike Bashkëkohore, Tiranë, 2008
- Nazmi MALIQI, Kontrolli dhe mbikëqyrja e Shërbimeve Sekrete të Sigurisë (Revistë e Shkencave Shoqërore, Vizione 11 dhe 12), Shkup, 2008-2009
- Ralph G. FELTHAM, Diplomacia, (Instituti i Studimeve Ndërkombëtare), Tiranë, 2010

Lista e Akteve Ligjore dhe Nënligjore

- Doracaku: "Kontrollueshmëria e Shërbimeve Sekrete, Standardet Ligjore dhe Praktika më e mirë", DICAF, Gjenevë, 2004
- Kodi i Etikës i OSBE-së, Pjesët 7 dhe 8, 1990-1999

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 9 prill 2008
- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, Nr. 52/91), 17 nëntor 1991
- Ligji i Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim, (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, Nr. 10/4922, 15 Shtator 1998), 2007
- Ligji për Informata të Klasifikuara, (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, Nr. 07-120/1, 12 Janar 2010), Shkup
- Ligji i Mbrojtjes, Neni 17, (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, Nr. 42/01 dhe 5/02 dhe 2006), Shkup
- Ligji i për Shërbim në Armatën e Republikës së Maqedonisë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, Nr:62/2002), Shkup
- Ligji për Menaxhimin me Kriza, (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, Nr. 29/05), 2005
- Ligji për Punë të Brendshme, (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, Nr. 07-3383/1), 24. 07. 2009
- Ligji për Punë të Jashtme (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, Nr. 07-1439/1), 2006
- Ligji për Siguri dhe Shpëtim, (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, Nr. 36/04 dhe 49/04), 2004
- Manual për parlamentarët Nr: 5, Mbikëqyrja Parlamentare në fushën e Sigurisë (Parimet, Mekanizmat dhe praktikat), IPU e DCAF, Gjenevë, 2003
- Rregullorja e Punës së Kuvendit të Kosovës, Numër: 03. 05.304. Prishtinë, 29 Prill 2010
- Rregullorja Për Punën e Parlamentit të Republikës së Maqedonisë, Nr: 130/2010, Shkup, 29 Shtator 2010
- Rregullorja për punën e Parlamentit të Republikës së Maqedonisë, Nr: 85/2002, 97/2006, 117/2006, 77/2008, 85/2009 dhe 07/2011

Ueb faqet e përdorura nga Interneti:

- [http:// www.president.gov.mk](http://www.president.gov.mk)
- [http:// www.mfa.gov.mk](http://www.mfa.gov.mk)
- [http:// www.nato.int](http://www.nato.int)
- [http:// www.kuvendikosoves.org/](http://www.kuvendikosoves.org/)
- [http:// www.mps-ks.org](http://www.mps-ks.org)